



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:242575

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06706610

CN.nr.13/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Alush Sinani dhe zyrtaren ligjore Eliza Shala, në çështjen juridike jokontestimore të propozuesit B.R.nga Ferizaj rruga “Ramadan Sylejmani” pn, me bazën juridike propozim për vërtetimin e datës së vdekjes për të ndjeren – nënen e tij Z.R., ish nga Ferizaj, në seancën gjyqësore me datë, 14.01.2025 merr këtë:

**A K T V E N D I M
PËR TËRHEQJEN E PROPOZIMIT**

I. Propozimi i propozusit B.R.nga Ferizaj rruga “Ramadan Sylejmani” pn, me bazën juridike propozim për vërtetimin e datës së vdekjes për të ndjeren – nënen e tij Z.R., ish nga Ferizaj **KONSTATOHET** se është tërhe

A r s y e t i m

Propozuesi, B.R.nga Ferizaj rruga “Ramadan Sylejmani” pn, me datë 04.09.2024, në këtë gjykatë, ka paraqitur kërkesë-propozimin, me bazën juridike propozim për vërtetimin e datës së vdekjes për të ndjeren – nënen e tij Z.R., ish nga Ferizaj.

Gjykata lidhur me këtë çështje jo kontestimore, ka treguar seancën përgaditore për datën 14.01.2025, ka ftuar propozusin, i cili gjatë seancës ka njoftuar gjykatën se bënë tërheqjen e propozimit për vërtetimin e datës së vdekjes për të ndjeren – nënen e tij Z.R., ish nga Ferizaj, sepse e ndjera ka jetuar dhe ka vdekur nga vdekja natyrore në Ferizaj ku edhe ishte vorrosur.

Me qenë se pala aktive në procedurë, vullnetarisht e ka tërhequr padinë, gjykata në kuptim të nenit 12, paragrafët 1, të Ligjit për Procedurën Jo Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke respektuar vullnetin e tij.

Nga te cekurat me lartë u vendosi në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2024:242575, 14.01.2025
CN.nr. 13/2024**

Gj y q t a r i
Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.